



**“Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare”
Dokumenti Përfundimtar**

(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 13, datë 27.08.2025)

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Regjimi i ri AP dhe shërbimet/kostot shitesë të AKEP	4
3. Tarifat administrative në vendet e tjera për AP	6
4. Tarifa administrative të lidhura me regjistrin e AP	9
Aneks 1: Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara të dhëna gjatë këshillimit publik	12

1. Hyrje

Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008.

Ligji nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC), dhe përmban ndryshime të rëndësishme në lidhje me përkufizimet e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, kategoritë dhe nënkategoritë e tyre, informacionin që duhet të deklarohet sipërmarrësit në kuadër të njoftimeve sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, përfshirë detyrimet dhe të drejtat e sipërmarrësve sipas autorizimit të përgjithshëm, dhe zbatimi i tyre nga ofruesit e shërbimeve/rrjeteve duhet të kryhet në përputhje me aktet rregullatore që AKEP do të nxjerrë për zbatimin e ligjit të ri.

Përcaktimet në Kreun III të ligjit nr.54/2024, përmbajnë disa ndryshime të rëndësishme për regjimin e autorizimit të përgjithshëm (në vijim, AP), të cilat do të reflektohen nga AKEP në Rregulloren përkatëse për AP sipas pikës 8 të nenit 27, që do të jetë objekt i një procesi të veçantë këshillimi publik me palët e interesuara.

Ligji nr. 54/2024 përmban dhe një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me buxhetin dhe financimin e AKEP si dhe parime për pagesat administrative/tarifat që paguajnë sipërmarrësit për të mbuluar kostot administrative të AKEP për të kryer funksionet e tij rregullatore, mbikëqyrëse si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ky dokument është përgatitur nga AKEP pas procedurës së këshillimit publik me palët e interesuara të dokumentit “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-Dokumenti për këshillim publik*” në lidhje me propozimin e AKEP për vendosjen e disa tarifave/pagesave administrative që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të paguajnë për shërbimet që do të kryhen nga AKEP në kuadër të implementimit të regjimit të AP sipas ligjit nr. 54/2024.

Kapitulli 2, përmban një përshkrim të regjimit të ri të AP dhe shërbimet/kostot shtesë të AKEP për AP sipas ligjit nr. 54/2024. Kapitulli 2, përmban shembuj të aplikimit të tarifave administrative të aplikura nga autoritete rregullatore në vende të BE-së, ndërsa kapitulli 4 përmban tarifa/pagesat administrative që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të paguajnë për shërbimet që do kryhen nga AKEP në kuadër të implementimit të regjimit të AP sipas ligjit nr. 54/2024.

Aneksi 1, i këtij dokumenti përmban qëndrimin e AKEP për komentet e palëve të interesuara të depozituara gjatë procesit të këshillimit publik të dokumentit “*Mbi caktimin e disa*

tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-Dokumenti për këshillim publik”¹,

2. Regjimi i ri AP dhe shërbimet/kostot shtesë të AKEP

Sipas pikës 3 të nenit 26: *Para fillimit të aktivitetit, çdo sipërmarrës njofton AKEP-in sipas një formulari të miratuar për mënyrat e njoftimit, bazuar në udhëzimet përkatëse të BEREC-ut, që përmban elementet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 27 të këtij ligji. Sipërmarrësit nuk i vendosen kërkesa shtesë ose të veçanta për njoftimin. Për ushtrimin e të drejtave, që rrjedhin nga autorizimi i përgjithshëm, sipërmarrësi i autorizuar nuk ka nevojë për marrjen e një vendimi apo akti administrativ të posaçëm nga AKEP-i. Me njoftimin dhe kur është i nevojshëm përdorimi i burimeve të kufizuara, sipërmarrësi fillon aktivitetin duke iu nënshtruar dispozitave për të drejtat e përdorimit, sipas këtij ligji, për pajisjen me autorizim individual.*

Sipas pikave 5 dhe 8 të nenit 27:

- *AKEP-i regjistron operatorët ose ofruesit e shërbimeve në bazën e të dhënave elektronike brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit dhe njofton regjistrimin e tyre me shkrim.*
- *AKEP-i miraton me rregullore formën dhe përmbajtjen e njoftimit, dokumentacionin mbështetës dhe konfirmimin e regjistrimit, duke marrë në konsideratë udhëzimet përkatëse të BEREC-ut.*

Sipas Nenit 33 “**Certifikata e konfirmimit për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave për instalimin e faciliteteve dhe interkoneksionit**”:

- 1. Me kërkesë të një sipërmarrësi, AKEP-i, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës, sipas rastit, lëshon një deklaratë të standardizuar, që konfirmon që sipërmarrësi ka paraqitur një njoftim, sipas pikës 3 të nenit 26 të këtij ligji. Certifikata e konfirmimit detajon rrethanat në të cilat çdo sipërmarrës që ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, sipas autorizimit të përgjithshëm ka të drejtë të instalojë facilitetet, të negociojë për interkoneksion ose të marrë akses e interkoneksion, me qëllim lehtësimin e ushtrimit të këtyre të drejtave gjatë aplikimit pranë niveleve të tjera të qeverisjes ose te sipërmarrësit e tjerë.*
- 2. Kur është e mundur teknikisht, certifikata e konfirmimit mund të lëshohet si përgjigje automatike pas njoftimit të përmendur në pikën 3 të nenit 26 të këtij ligji.*

Sa më sipër, AKEP në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me regjimin e AP:

- do të përgatisë një Rregullore të re për AP dhe formular të ri të njoftimit sipas AP, i cili duhet të jetë sipas modelit të BEREC, të aplikuar në të gjitha vendet e BE-së;
- do të krijojë një regjistër të ri të AP me të dhënat e deklaruara nga të gjithë sipërmarrësit dhe publikojë këtë regjistër të ri me shumë më tepër informacion dhe funksionalitet dhe aksesueshmëri me përfitim për të gjitha palët e interesuara (sipërmarrësit, autoritete

¹ Dokumenti për këshillim publik i miratuar nga AKEP me VKD nr.2, datë 19.03.2024, u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 26.03.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 26.04.2025

kompetente për dhënie leje të instalimit/ndërtimit të faciliteteve/rrjeteve të komunikimeve elektronike etj.)

- do të shqyrtojë të gjitha njoftimet e reja sipas Rregullores dhe formularit të ri të AP të sipërmarrësve ekzistues (rreth 256 sipërmarrës sipas Regjistrit aktual të AP), dhe sipërmarrës të tjerë të rinj, përfshirë ndryshimet e mundshme në njoftimet përkatëse të sipërmarrësve.

Shërbimet që do ofrojnë AKEP në lidhje me AP:

- do të pajisë me Certifikatë të Konfirmimit të Njoftimit/Regjistrimit (CKNJ) të gjithë sipërmarrësit që do të regjistrohen në Regjistrin e ri të AP, si dhe do të lëshojë, me kërkesë të sipërmarrësit (sipas pikës 1 të Nenit 33) Deklaratë/Certifikatë të Konfirmimit për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave të sipërmarrësit për instalimin e faciliteteve dhe interkoneksion;
- do të lëshojë Certifikatë të Konfirmimit të Ndryshimeve të të dhënave autorizim/Njoftimin për rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike.

Puna rregullatore dhe shërbimet e cituara më sipër të ofruara nga AKEP për sipërmarrësit për pajisjen e tyre me certifikatat e cituara më sipër krijojnë kosto shtesë për AKEP të shkaktuara nga proceset përkatëse të lëshimit të certifikatave për secilin sipërmarrës dhe nuk janë kosto/shpenzime periodike pasi varen numri i aplikimeve për regjistrim të ri, ndryshime në njoftime etj.

Ligji nr. 54/2024 përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me buxhetin dhe financimin e AKEP si dhe parime për pagesat administrative/tarifat që paguajnë sipërmarrësit për të mbuluar kostot administrative të AKEP për të kryer funksionet e tij rregullatore, mbikëqyrëse si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Sipas pikës 1 të nenit 17, burimet e financimit të AKEP-it janë pagesat që bëhen nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. AKEP-i financohet edhe nga burime të tjera të ligjshme.

Sipas pikës 1 të nenit 18 (Parimet për pagesat administrative):

Çdo pagesë administrative e bazuar në këtë ligj, e vendosur ndaj sipërmarrësve që ofrojnë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike, sipas autorizimit të përgjithshëm ose që u është dhënë e drejta e përdorimit:

a) mbulon në total vetëm kostot administrative të shkaktuara në menaxhimin, kontrollin dhe zbatimin e sistemit të autorizimit të përgjithshëm, të drejtave të përdorimit, si dhe detyrimeve të veçanta, siç referohen në nenin 34 të këtij ligji, të cilat mund të përfshijnë kostot për bashkëpunimin ndërkombëtar, harmonizimin dhe standardizimin, analizat e tregut, monitorimin e përputhshmërisë e kontrollet e tjera të tregut, si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, si dhe vendimeve administrative, të tilla si vendimet për aksesin, interkoneksionin; dhe

b) imponohet ndaj sipërmarrjeve individuale në mënyrë objektive, transparente dhe proporcionale, për të minimizuar kostot administrative shtesë ose tarifat shoqëruese në lidhje me qëllimin e synuar të tyre, duke marrë parasysh objektivat e përgjithshëm të këtij ligji.

Bazuar në parimet e pagesave administrative të nenit 18 të ligjit nr. 54/2024 kostot e shërbimeve të AKEP për regjistrimin dhe/ose lëshimin e certifikatave të konfirmimeve të cituara më sipër nuk mund të mbulohen nga pagesat periodike vjetore të sipërmarrësve për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 20, pasi janë kosto që nuk mund të parashikohen nga AKEP dhe pagesa vjetore e mbikëqyrjes synon mbulimin e shpenzimeve periodike vjetore.

Burimet e tjera të financimit të AKEP si pagesa për frekuenca dhe numeracion sipas përcaktimeve të neneve 19, 21 dhe 22 të ligjit nr. 54/2024 duhet të përdoren për menaxhimin e këtyre burimeve dhe pjesë e shpenzimeve të AKEP për zbatimin e detyrimeve të autorizimeve individuale dhe jo të regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

3. Tarifat administrative në vendet e tjera për AP

Regjimi i AP është implementuar fillimisht në vendet e BE-së sipas direktivave 2002 të BE, dhe në vitet e fundit sipas EECC.

Nga informacioni që AKEP ka disponuar në lidhje me të dhënat për pagesat/tarifat administrative që paguajnë sipërmarrësit që janë objekt AP në vendet e BE-së, rezulton se në disa vende, përveç tarifave vjetore në proporcion me xhiron/të ardhurat e sipërmarrësve nga komunikimeve elektronike, aplikohen dhe tarifa fikse:

- tarifa One-off (aplikohen vetëm një-herë) për regjistrimin/njoftimin për herë të parë të sipërmarrësit dhe për ndryshim.
- tarifa fikse vjetore + tarifë në përqindje ndaj xhiros.

Tabela 1: Tarifa fikse të lidhura me regjistrin e Autorizimit të Përgjithshëm në vende të BE-së (2024)

	Tarifa One-off/Fikse	Euro
Belgjika	Tarifë regjistrimi/ Registration fee	867
Bullgaria	Certifikata Konfirmimi (me kerkese)	7.67
Qipro	Tarifë regjistrimi/ Registration fee	850
Greqi	Tarifë për njoftimin fillestar/Initial fee	300
	Ndryshimet/Ammendments	100
Luksemburg	Tarifa e njoftimit te pare	2500
Malta	Tarifa fikse vjetore + 1.1% te te ardhurave	12.500/2500
Portugali	Tarifë për njoftimin fillestar/Initial fee	700
Suedi	Tarifë njoftimi/Notification fee	88.66

Burimi: Cullen International, General authorisation regime: notification and national registration requirements and administrative charges.

Më poshtë janë dhënë më shumë detaje për tarifat fikse të aplikuara në disa prej vendeve të BE-së të referuara në tabelën e mësipërme.

Belgjika:

Çdo sipërmarrës i regjistruar në regjistrin e AP në Belgjikë, paguan një tarifë fikse bazë si Tarifë Regjistrimi për njoftimin e një rrjeti ose shërbimi ose 2 ose më shumë rrjete/shërbime (bundled notification) regjistrimin për herën e parë (Tabela më poshtë).

Tarifa e Regjistrimit	Vlerat për vitin 2025
1 x rrjet publik i komunikimeve elektronike	€ 904
1 x shërbim komunikimi elektronik	€ 904
Njoftim I bashkuar (= për 2 shërbime/rrjete)	€ 1,808
Shërbimi ose rrjet jofitimprurës	€ 166
Shërbimi ose rrjet tjetër	€ 166
Njoftim i bashkuar	€ 331

Burimi: <https://www.bipt.be/operators/costs-and-fees>

Në vitet në vijim, çdo sipërmarrës paguan tarifë vjetore administrative në bazë të nivelit të xhiros/të ardhurat e sipërmarrësit nga komunikimet elektronike ku pagesat/tarifat janë të ndara në intervale/fasha sipas xhiros së sipërmarrësve dhe tarifa vjetore fillojnë nga 845 euro, për xhiro 0-1 milion Euro, pra e aplikueshme dhe për sipërmarrës me xhiro 0 euro.

Malta

Në Maltë sipërmarrësit paguajnë një **Tarifë vjetore fikse** sipas rrjetit/shërbimit të njoftuar (tabela më poshtë) + tarifë vjetore për mbikëqyrjen në bazë të xhiros (deri në 1.1% të të ardhurave bruto totale të sipërmarrësit nga komunikimet elektronike)

Rrjetet/shërbimet	Tarifa fikse vjetore (Euro)
(a) Rrjete publike të komunikimit elektronike	€ 12,000
(b) shërbime të komunikimit zanor	€ 12,000
(c) Shërbim i aksesit në internet	€ 2,500
(d) shërbime të shpërndarjes/transmetimit TV dhe radio	€ 12,000
(e) shërbime të tjera të komunikimeve elektronike	€ 2,500

Burimi: Ligji EECC i Maltës (Skeduli 12, Part A. Administrative charges to be paid on an annual basis)

Qipro

Tarifa e regjistrimit (one-off) është 850 €, ose 425€ për regjistrimet gjatë gjysmës së dytë të vitit. Çdo vit pas regjistrimit, kompanitë duhet të paguajnë tarifat vjetore administrative (minimumi €850).

Tarifat vjetore llogariten si përqindje e të ardhurave totale bruto vjetore nga komunikimet elektronike në Qipro,

4. Tarifa administrative të lidhura me regjistrin e AP

Për të mbuluar kostot administrative shtesë të AKEP në lidhje me shërbimet e ofruara për regjistrimin në regjistrin e ri të AP dhe lëshimin e certifikatave përkatëse në zbatim të ligjit të ri nr. 54/2024, si dhe bazuar në praktika në vendet e BE-së, AKEP gjykon të arsyeshme vendosjen e pagesave/tarifave të mëposhtme administrative:

Tabela 2: Tarifat administrative për shërbime të AKEP për regjistrin e AP

Nr.	Shërbimi i AKEP	Përshkrim	Tarifa
1.	Lëshimi i Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit/Regjistrimit (CKNJ)	CKNJ lëshohet për cdo sipërmarrës pas njoftimit dhe regjistrimit në Regjistrin e AP, sipas pikës 5 të Nenit 27 të Ligjit 54/2024. Tarifa aplikohet vetëm një herë (one-off) për regjistrimin e parë të sipërmarrësit në Regjistrin e ri të AP.	50.000 Lekë
2.	Lëshimi i Deklaratës/Certifikatës së Konfirmimit për lehtësimin e ushtrimit të të drejtave për instalimin e faciliteteve dhe interkoneksion	Deklarata/Certifikata lëshohet me kërkesë të sipërmarrësit, sipas pikës 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 54/2024.	50.000 Lekë
3.	Lëshimi i Certifikatës së Konfirmimit të Ndryshimeve të të dhënave autorizim/CKNJ	Certifikata lëshohet në rastet e njoftimit nga sipërmarrësi të ndryshimeve të ndodhura në informacionin e dhënë fillestar ose atë pararendës, në CKNJ që AKEP lëshon për konfirmimin e regjistrimit të njoftimit mbi ndryshimin e ndodhur (sipas përcaktimeve në Rregulloren e AP)	20.000 Lekë

Shënim: Tarifat janë pa TVSH.

Tarifa (nr.1) për Lëshimin e Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit/Regjistrimit (CKNJ) do të jetë e aplikueshme ndaj:

- sipërmarrësve ekzistues të regjistruar në regjistrin aktual të AP për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe që do të duhet të njoftojnë sërish në AKEP sipas formularit të ri të njoftimit për regjistrim në Regjistrin e AP sipas ligjit nr. 54/2024 dhe Rregullores së AP që AKEP do të miratojë sipas pikës 6 të nenit 27 të ligjit nr. 54/2024;
- sipërmarrësve të rinj që do të njoftojnë për herë të parë në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike

Tarifa do të aplikohet vetëm pas konfirmimit të regjistrimit të sipërmarrësit përkatës në regjistrin e AP, dhe nuk pengon sipërmarrësit në ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të njoftuara dhe konfirmuara nga AKEP.

Tarifa (nr. 3) për çdo ndryshim në të dhënat e AP të sipërmarrësit pas njoftimit për herë të parë do të aplikohet për çdo ndryshim të rëndësishëm në shërbimin/shërbimet e ofruara nga çdo sipërmarrës që njofton ndryshime dhe synon minimizimin e kostove shtesë të AKEP për shqyrtimin e ndryshimeve dhe reflektimin e tyre në regjistrin e AP.

Faturat për shërbimet e mësipërme do të jenë të fiskalizuar dhe një kopje e printuar dhe elektronike e tyre paralelisht do të dërgohen nga AKEP sipërmarrësve së bashku me certifikatat përkatëse në adresat përkatëse (fizike dhe elektronike/email) të deklaruara në regjistrin e AP.

AKEP, konsideron se tarifat/pagesat administrative të mësipërme janë në përputhje me parimet e nenit 18 pasi ato:

- Synojnë të mbulojnë kostot administrative shtesë të AKEP në lidhje me regjistrimin për herë të parë të sipërmarrësve në regjistrin e ri të AP, si dhe
- punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore për AP në zbatim të ligjit 54/2024;
- janë transparente dhe proporcionale, për të minimizuar kostot administrative shtesë të AKEP për shqyrtimin e çdo njoftimi për herë të parë sipas AP të re si dhe çdo ndryshimi të mëvonshëm në njoftimin nga sipërmarrësi përkatës.
- kanë përputhje me parimin shkallë-pasoje për mbulimin e kostove;
- janë të arsyeshme dhe nuk përbëjnë barrë të rëndë apo të tepërt financiare për sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- adresojnë dhe problematika të evidentuara nga mbledhja e tarifës së mbikëqyrjes.
- Sipas pikës 3 të nenit 17, *Çdo tepricë nga të ardhurat nga pagesat rregullatore, që mbetet pa u shpenzuar në përfundim të vitit financiar, mbahet në llogaritë e AKEP-it, përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe përdoret për investime të nevojshme për kryerjen e detyrave të AKEP-it, si dhe mbahet parasysh në rishikimin proporcional, objektiv, transparent dhe jodiskriminues të pagesave përkatëse vjetore të sipërmarrësve.*

Sa më sipër, çdo tepricë nga të ardhurat nga tarifat e mësipërme mund të përdoret nga AKEP në vitin pasardhës.

Problematika nga tarifa e mbikëqyrjes

Tarifa e mbikëqyrjes së tregut e aplikuar sipas ligjit nr. 9918/2008 dhe që do të vijojë të aplikohet dhe sipas ligjit nr. 54/2024 në bazë të xhiros së deklaruara nga sipërmarrësit është e shoqëruar me një sërë problematikash dhe risqe të nën-deklarimit:

- një numër të lartë sipërmarrësish që janë persona fizikë dhe nuk janë objekt i legjislacionit të përgatitjes së pasqyrave financiare.
- diferenca të mëdha midis të ardhurave totale të subjektit dhe të ardhurave nga komunikimet elektronike
- numër i lartë sipërmarrësish që deklarojnë të ardhura nga komunikimet elektronike në nivele shumë të ulëta:
 - kostot administrative të AKEP për llogaritjen, faturimin dhe mbledhjen e pagesës së mbikëqyrjes më e lartë se pagesa e mbledhur;
 - Fatura për mbikëqyrjen < 10.000 lekë: 43 operatorë total (233,944 lekë);
 - 19 fatura me vlerë 900-5000 lekë (53,715 lekë);
 - të ardhurat e deklaruara nga komunikimet elektronike nga sipërmarrësit që nuk mbulojnë as pagën mesatare për një punonjës.
- treguesi ARPU (të ardhura mesatare për përdorues) i llogaritur për sipërmarrësit ISP është në nivele shumë të ulëta krahasuar me tarifatat mujore konkurruese për akses BB nga rrjete fikse:
 - ARPU < 500 lekë/muaj (42-499 lekë): 62 ISP/82126 pajtimtarë
 - ARPU < 1000 lekë/muaj: 132 ISP / 226913 pajtimtarë.

AKEP, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 54/2024, neni 20, do të kryejë një proces të veçantë këshillimi publik, mbi rregulloren për pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

ANEKS 1: QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E PALËVE TË INTERESUARA TË DHËNA GJATË KËSHILLIMIT PUBLIK

AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 02, datë 19.03.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik “*Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare*”. Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AKEP-it, më datë 26.03.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 26.04.2025.

Në përfundim të procesit të këshillimit publik në AKEP depozituan komente palët e interesuara si më poshtë:

- Sipërmarrësi Albanian Fiber Telecommunications sh.p.k., me shkresën nr. 143 prot., datë 24.04.2025 (Ref. AKEP: nr. 732 prot., datë 25.04.2025);
- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., me shkresën me referencë LEA/029/L.R/E.K, datë 22.04.2025 (Ref. AKEP: nr. 732/1 prot, datë 28.04.2025);
- Sipërmarrësi One Albania sh.a., me shkresën nr. 979 prot., datë 25.04.2025 (Ref. AKEP: nr.732/2 prot., datë 28.04.2025);
- Sipërmarrësi Albanian Satellite Communication sh.a., në rrugë elektronike, më datë 28.04.2025

AKEP, falenderon palët e interesuara për komentet dhe sugjerimet e dhëna, të cilat janë dhënë më poshtë të sintetizuara sipas pyetjeve të këshillimit publik së bashku me qëndrimin e AKEP për komentet e dhëna.

PYETJE KËSHILLIMI NR.1:

A jeni dakord në parim me propozimin e AKEP për vendosjen e tarifave administrative për lëshimin e certifikatave të konfirmimit për regjistrin e Autorizimit të Përgjithshëm (AP)?

KOMENTE:

Sipërmarrësit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme:

- i. parimisht dakord për caktimin e këtyre pagesave.*
- ii. kundër, me argumentimin se nuk ka bazë të qartë ligjore për caktimin e tyre;*
- iii. zbatimi i rregullores së re të Autorizimit të Përgjithshëm, nuk duhet të ketë efekt prapaveprues për operatorët ekzistues me më shumë se 15 vjet aktivitet dhe se duhet të aplikohet rritje progresive e tarifës administrative për ndryshimet në të dhëna.*

QËNDRIMI I AKEP

Ligji nr. 54/2024, përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me buxhetin dhe financimin e AKEP, (neni 17) si dhe parime për pagesat administrative, që paguajnë sipërmarrësit për të mbuluar kostot administrative të AKEP për të kryer funksionet e tij rregullatore, mbikëqyrëse si dhe punën rregullatore për përgatitjen dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, (neni 18, pika 1). Bazuar në sa më sipër, ligji nuk ndalon vendosjen e tarifave për mbulimin e kostove për shërbime të këtij lloji, por kërkon që ato të jenë të arsyeshme dhe proporcionale, parim i përsëritur në përmbajtje të ligjit.

Bazuar në parimet e pagesave administrative, kostot e shërbimeve të AKEP për regjistrimin dhe/ose lëshimin e certifikatave të konfirmimeve, nuk mund të mbulohen nga pagesat periodike vjetore të sipërmarrësve për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 20 të ligjit nr. 54/2024, pasi janë kosto që nuk mund të parashikohen nga AKEP dhe pagesa vjetore e mbikëqyrjes synon mbulimin e shpenzimeve periodike vjetore.

Burimet e tjera të financimit të AKEP si pagesa për frekuenca dhe numeracion, sipas përcaktimeve të neneve 19, 21 dhe 22 të ligjit nr. 54/2024, duhet të përdoren për menaxhimin e këtyre burimeve dhe pjesë e shpenzimeve të AKEP për zbatimin e detyrimeve të autorizimeve individuale dhe jo të regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Po kështu, ligji nr. 54/2024 përcakton një kuadër të ri rregullator, ku procesi i konfirmimit është i detyrueshëm për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike, pavarësisht kohëzgjatjes së aktivitetit të tyre, e si pasojë këta subjekte, nuk mund të përjashtohen nga pagesat. Sipërmarrësit ekzistues, të regjistruar në regjistrin aktual të AP, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, do duhet të njoftojnë sërish në AKEP për rifresikimin e të dhënave, moment që do t'i shërbejë AKEP për verifikimin e përmbushjes nga ana e tyre të kërkesave ligjore, sipas formularit të ri të njoftimit për regjistrim në Regjistrin e AP sipas ligjit nr. 54/2024

PYETJE KËSHILLIMI NR.2:

A mendoni se tarifat administrative të propozuara nga AKEP, janë të arsyeshme?

KOMENTE:

Sipërmarrësit, propozojnë pagesa të diferencuara për lëshimin e Certifikatës për Konfirmimin e Njoftimit, (CKNJ) duke propozuar që vlera e kësaj pagese të jetë më e madhe për sipërmarrësit e rinj në tregun e komunikimeve elektronike, duke qenë se puna administrative e AKEP për përpunimin e të dhënave të operatorëve ekzistues, tashmë pjesë të regjistrave të AKEP, është më e vogël.

QËNDRIMI I AKEP

Në funksion të zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, AKEP, po përgatit një Rregullore të re për Autorizimin e Përgjithshëm (AP) dhe formular të ri të njoftimit sipas kushteve të kësaj rregullore dhe modelit të BEREC, të aplikuar në të gjitha vendet e BE-së. Po kështu, do të krijojë dhe publikojë një regjistër të ri të AP me të dhënat e deklaruara nga të

gjithë sipërmarrësit me shumë më tepër informacion dhe funksionalitet dhe aksesueshmëri me përfitim për të gjitha palët e interesuara (sipërmarrësit, autoritete kompetente për dhënie leje të instalimit/ndërtimit të faciliteteve/rrjeteve të komunikimeve elektronike etj.), do të shqyrtojnë të gjitha njoftimet e reja sipas Rregullores dhe formularit të ri të AP të sipërmarrësve ekzistues (rreth 256 sipërmarrës sipas Regjistrimit aktual të AP), dhe sipërmarrës të tjerë të rinj, përfshirë ndryshimet e mundshme në njoftimet përkatëse të sipërmarrësve.

Gjithashtu, AKEP, po punon për përmirësimin e sistemit AURA, me më shumë informacion, funksionalitet dhe aksesueshmëri, i cili do të mundësojë digjitalizimin e plotë të procedurave të njoftimit dhe regjistrimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, që do të shërbejë si platformë për njoftimin, regjistrimin, administrimin dhe monitorimin e operatorëve që ofrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike.

Puna rregullatore dhe shërbimet e sipërpërmendura, nga AKEP që përfshin sipërmarrësit ekzistues dhe sipërmarrësit e rinj, për pajisjen e tyre me certifikatat përkatëse, krijojnë kosto shtesë për AKEP të shkaktuara nga proceset përkatëse të lëshimit të certifikatave për secilin sipërmarrës dhe nuk janë kosto/shpenzime periodike pasi varen numri i aplikimeve për regjistrim të ri, ndryshime në njoftime etj.

Ndaj në kushtet kur, AKEP, është një institucion me vetëfinancim, çdo shpenzim/kosto shtesë administrative e diktuar nga regjimi i ri i autorizimit të përgjithshëm, sipas kërkesave të ligjit nr. 54/2024, është i arsyeshëm dhe nuk përbën barrë të rëndë apo të tepërt financiare për sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

PYETJE KËSHILLIMI NR. 3:

A keni sugjerime alternative ose plotësuese që ndihmojnë AKEP në përmbushjen e objektivave të tij, përfshirë sigurimin e financimit të kostove të veprimtarisë së tij dhe shpërndarjen e drejtë, të ndershme, dhe proporcionale të kësaj barre financiare mes sipërmarrësve të komunikimeve elektronike?

KOMENTE:

- a. Pagesa e tarifës administrative, të jetë kusht paraprak për regjistrimin dhe për lëshimin e CKNJ.*
- b. Vendosjen e një tarife administrative më të ulët për deklaratat standarde (p.sh., për lehtësimin e të drejtave për facilitete), në vlerën 10,000 (dhjetëmijë) lekë, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe kostos reale, për dokumente që nuk kërkojnë verifikim të thelluar.*
- c. Kryerjen e verifikimeve për evazionin fiskal dhe informalitetin në treg dhe mbikëqyrje më të fortë ndaj ISP-ve që raportojnë të ardhura shumë të ulëta ose shmangin detyrimet.*
- d. Krite vlerësimi për operatorët e rinj (kapital minimal, verifikim i të dhënave, etj.)*
- e. Operatorët e vegjël që ndajnë të njëjtin infrastrukturë, në të njëjtën rrjet nuk duhet të paguajnë veçmas për çdo rast.*
- f. Operatorët me xhiro të ulët të mos jenë automatikisht të drejtpërdrejtë për certifikatë konfirmuese Propozohet caktimi i kapitalit minimal në raport me zonën e shërbimit.*

- g. Operatorët që ushtrojnë aktivitet vetëm në një bashki, nuk duhet të paguajnë tarifë të plotë.*

QËNDRIMI I AKEP

Për sa më sipër, AKEP, shprehet se:

- a. Pika 7 e nenit 27 të ligjit nr. 54/2024, parashikon se, nëse AKEP, nuk konfirmon regjistrimin brenda afatit ligjor ose nuk i kërkon sipërmarrësit sqarime shtesë, regjistrimi konsiderohet i përfunduar. Në të tilla raste, kur AKEP nuk përgjigjet brenda afatit, do të trajtohet sipas përcaktimit ligjor, të sipërcituar, por pa lëshuar automatikisht certifikatën. Pagesa e tarifës administrative, është kusht për lëshimin e certifikatës, jo për vlefshmërinë e vetë njoftimit.
- b. AKEP, vlerëson se edhe në rastin e tarifës administrative të përcaktuar, në zbatim të nenit 33, pika 1, vlen i njëjti arsyetim si në rastin e lëshimit të Certifikatës të Konfirmimit të Njoftimit. Dokumenti që do t'u lëshohet sipërmarrësve me kërkesë të tyre, do të shërbejë për instalimin e faciliteteve, negociimin e interkoneksionit, në raport me institucionet publike ose sipërmarrës.
- c. Neni 184 i ligjit nr. 54/2024, parashikon masa ndëshkimore për shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit. AKEP, ka detyrim ligjor që të kontrollojë dhe të verifikojë të dhënat e operatorëve dhe bashkëpunimi me organet tatimore është i nevojshëm.
- d. Ligji parashikon në germen b) të pikës 3 të nenit 27, përmbushjen e kërkesës për deklaratën e zotërimit të kapaciteteve teknike, ligjore dhe financiare, si dhe vlerësimin e AKEP për përmbushjen e kushteve të regjistrimit. Ky parashikim i drejtohet të gjithë sipërmarrësve, përfshirë ekzistuesit të cilët me hyrjen në fuqi të Rregullores së re të Autorizimit të Përgjithshëm, do të plotësojnë formularin e ri të njoftimit, sipas kushteve të kësaj rregullore dhe modelit të BEREC. Ky parashikim, i jep të drejtën AKEP, për të kërkuar dokumentacion mbështetës dhe për të verifikuar rastet që paraqesin rrezik për shmangie ose spekulim në njoftimin e sipërmarrësit.
- e. AKEP, vlerëson se çdo sipërmarrës, trajtohet në mënyrë të pavarur për efekt të konfirmimit të njoftimit. Trajtimi është administrativ dhe i njëjtë për të gjithë sipërmarrësit: elemente si, zona e ofrimit të shërbimit, fuqia ekonomike e subjektit, jetëgjatësia e tij në treg, nuk janë objekt vlerësimi/ndikimi për këtë proces, i cili lidhet me shqyrtimin administrativ.
- f. Ky sugjerim, nuk gjen mbështetje në dispozitat aktuale të ligjit nr. 54/2024, pasi referuar regjimit të ri të AP, të gjithë sipërmarrësit, ekzistues dhe të interesuar për ofrimin e rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, janë objekt i pajisjes me këtë certifikatë
- g. Shtrirja gjeografike nuk është kriter për përjashtimin nga aplikimi i tarifës administrative.